

## Organizata për siguri dhe bashkëpunim në Evropë MISIONI NË KOSOVË

### Raporti 03/2007 i Shtyllës së III-të (OSBE) Mbi monitorimin e Kuvendit të Kosovës 14 maj 2007 – 22 korrik 2007

#### Titujt kryesor

- Kuvendi miraton në parim amendamentet në Rregulloren e Punës
- Kuvendi miraton në parim projektligjin për dokumentet e udhëtimit
- Kryeministri i drejtohet Kuvendit në përgjigje të interpelancës së parashtruar nga ORA
- Ministri për energji dhe miniera i drejtohet Kuvendit në përgjigje të interpelancës së parashtruar nga PDK-ja
- Kuvendi diskuton për regjistrimin e popullsisë

#### 1. Sfond

Raporti i pesëdhjetedytë i monitorimit është hartuar në përputhje me pikëpamjet referuese të Shtyllës së tretë të UNMIK-ut për themelimin e institucioneve (OSBE) dhe monitorimin e Kuvendit të Kosovës prej datës 26 nëntor 2002 dhe bazohet në Rregulloren e re të punës, të miratuar në fund të seancës plenare më 20 maj 2005 dhe të reviduar në seancën e mbajtur më 1-2 qershor 2006.

Gjatë periudhës raportuese, Kuvendi ka mbajtur katër seanca plenare të rregullta, më 31 maj/1 dhe 4 qershor, 21 qershor, 28 qershor dhe më 12 korrik si dhe katër mbledhje të Kryesisë, më 25 maj, 14 qershor, 5 korrik dhe 20 korrik. Dhjetë komisionet dhe nënkomisioni për të drejtat e njeriut, barazi gjinore, peticione dhe ankesa publike kanë mbajtur mbledhje gjatë periudhës raportuese.<sup>1</sup> Shtylla e III-të (OSBE) i ka monitoruar seancat plenare dhe mbledhjet e Kryesisë, si dhe 45 prej 69 mbledhjeve të komisioneve dhe tri dëgjime publike.<sup>2</sup>

<sup>1</sup> Komisioni për buxhet dhe financa është takuar më 29 maj, 12 dhe 29 qershor, 16 dhe 17 korrik, derisa Komisioni për të drejtat dhe interesat e komuniteteve është takuar më 23 maj, 6, 10 dhe 27 qershor, 4 dhe 16 korrik. Komisioni për çështje gjyqësore, legjislative dhe Kornizë kushtetuese është takuar më 14 dhe 21 maj, 4, 11 dhe 18 qershor dhe 9 korrik, derisa Komisioni për siguri është takuar më 13 dhe 27 qershor, 4 dhe 6 korrik. Komisioni për bashkëpunim ndërkombëtar dhe integritet në EU-NATO është takuar më 18 qershor, derisa Komisioni për shërbime publike, administrate lokale dhe media është takuar më 16, 21 dhe 28 maj, 8 dhe 25 qershor dhe 11 korrik. Komisioni për arsim, shkencë, teknologji, kulturë, rini dhe sport është takuar më 15, 23, 29 dhe 30 maj, 12, 14, 18 dhe 26 qershor, 2, 3 dhe 18 korrik, derisa Komisioni për ekonomi, tregti, industri, energji, transport dhe telekomunikacion është takuar më 15, 21, 22 dhe 30 maj, 13 dhe 26 qershor, 2, 10 dhe 17 korrik. Komisioni për bujqësi, pylltari, zhvillim rural, mjedis dhe planifikim hapsinor është takuar më 15 dhe 22 maj, 5, 12, 19 dhe 26 qershor, 3 dhe 17 korrik. Komisioni për shëndetësi, punë, mirëqenie sociale dhe personat të pagjetur është takuar më 23 dhe 30 maj, 7 dhe 19 qershor, 3, 5, 10, 16 dhe 17 korrik. Nënkomisioni për të drejtat e njeriut, barazi gjinore dhe peticione dhe kërkesa publike është takuar më 16 dhe 25 maj, 6 qershor dhe 18 korrik. Më 16 maj, Komisioni për siguri ka mbajtur dëgjim publik lidhur me sulmet kundër agjencive të pavarura. Më 17 maj, Komisioni për arsim, shkencë, teknologji, kulturë, rini dhe sport ka mbajtur dëgjim publik lidhur me mënyrën e zbatimit të Ligjit për Kinematografinë. Më 22 maj, Komisioni për arsim, shkencë, teknologji, kulturë, rini dhe sport ka mbajtur dëgjim publik lidhur me auditimin çështjeve gjinore në sistemin arsimor. Më 28 maj, Komisioni për ekonomi, tregti, industri, energji, transport dhe telekomunikacion ka mbajtur dëgjim publik lidhur me vlerësimin e projektligjit për ndërmarjet.

<sup>2</sup> Komisionin për buxhet dhe financa më 29 maj, 12 dhe 29 qershor, 16 dhe 17 korrik; Komisionin për të drejtat dhe interesat e komuniteteve më 23 maj, 6, 10 dhe 27 qershor, 4 dhe 16 korrik; Komisionin për çështje gjyqësore, legjislative dhe Kornizë kushtetuese më 14 dhe 21 maj, 4 dhe 11 qershor dhe 9 korrik; Komisionin për siguri më 13 qershor dhe 6 korrik; Komisionin për shërbime publike, administrate lokale dhe media më 21 maj, 25 qershor dhe 11 korrik; Komisionin për arsim, shkencë, teknologji, kulturë, rini dhe sport më 15, 23 dhe 30 maj, 12, 14 dhe 26 qershor dhe 18 korrik; Komisionin për ekonomi, tregti, industri, energji, transport dhe telekomunikacion më 15 dhe 22, 13 qershor, 3, 10 dhe 17 korrik; Komisionin për bujqësi, pylltari, zhvillim rural, mjedis dhe planifikim hapsinor më 22 maj, 12, 19 dhe 26 qershor, 3 dhe 17 korrik; Komisionin për shëndetësi, punë, mirëqenie sociale dhe personat të pagjetur më 30

## 2. Vështrim

**Seancën plenare të Kuvendit të Kosovës të mbajtur më 31 maj/1 dhe 4 qershor** e kryesoi Kryetari i Kuvendit Kolë Berisha dhe anëtarë të Kryesisë z. Gazmend Muhaxheri (ORA).

- Tetëdhjetë e dy, 70 dhe 78 deputetë ishin të pranishëm në seancë më 31 maj, 1 qershor, përkatësisht 4 qershor.<sup>3</sup>
- Pikat kryesore të rendit të ditës të seancës plenare të 31 majit/1 dhe 4 qershorit:
  - Pyetjet për Qeverinë për përgjigje gojore
  - Interpelanca e ORA-s për Kryeministrin (Shiko më poshtë pjesën e titulluar “Interpelanca”.)
  - Shqyrtimi i parë i projektligjit për vlerësimin e ndikimit në mjedis (Projektligji është tërhequr nga sponzoruesi. Shiko më poshtë paragrafin e dytë të pjesa “Procesi legjislativ”.)
  - Shqyrtimi i parë i projektligjit për statusin civil (Projektligji është miratuar në parim me 64 vota për dhe pa vota kundër.)
  - Shqyrtimi i parë i projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr 46/2004 për regjistrat e statusit civil (Projektligji është miratuar në parim me 61 vota për dhe një votë kundër.)
  - Shqyrtimi i parë i projektligjit për ndryshimin e Ligjit nr 2004/1 për transportin rrugor (Projektligji është miratuar në parim me 61 vota për dhe pa vota kundër.)
  - Shqyrtimi i raportit të punës së Qeverisë për vitin 2006 (Kryeministri Agim Çeku e bëri prezantimin e raportit pasuar nga shefat e grupeve parlamentare, disa deputetë të tjerë dhe deklaratën përmbyllëse nga Kryeministri.)
  - Debat mbi tarifatat dhe politikatat e energjisë (Znj. Teuta Sahatqija (ORA) si sponzoruese e debatit bëri deklaratën hyrëse pasuar nga Ministri për energji dhe miniera Et’hem Çeku, deklaratat në emër të grupeve parlamentare, disa deputetë të tjerë dhe deklarata përmbyllëse nga Znj. Sahatqija.)
  - Shqyrtimi i rekomandimit të Komisionit për ekonomi, tregti, industri, energji, transport dhe komunikacion lidhur me emërimin anëtarëve në komisionin për konkurrencë (Emërimi i pesë anëtarëve të propozuar është refuzuar meqë asnjë kandidat nuk ka marrë mbështetjen e shumicës absolute të deputetëve ashtu siç kërkohet në Ligjin për Konkurrencën.)
  - Shqyrtimi i rekomandimit të Komisionit për bujqësi, pylltari, zhvillim rural, ambient dhe planifikim hapësinor lidhur me emërimin e anëtarëve të Bordit të Ujërave (Emërimi i shtatë anëtarëve të propozuar është miratuar me shumicë votash për.)
  - Shqyrtimi i rekomandimit të Komisionit për çështje gjyqësore, legjislative dhe Kornizë Kushtetuese për kthimin e projektligjit për ndërmjetësimin Qeverisë (Projektligji i është kthyer Qeverisë me 56 vota për dhe tri vota kundër. Shiko më poshtë paragrafin e dytë të pjesa e titulluar “Procesi legjislativ”.)
  - Shqyrtimi i rekomandimit të Komisionit për çështje publike, administratë lokale dhe media lidhur me raportin për vitin 2006 të Komisionit të Pavarur të Mediave (KPM) (Raporti i KPM-së është miratuar me 49 vota për dhe 13 vota kundër.)
  - Shqyrtimi i rekomandimit të Komisionit për çështje gjyqësore, legjislative dhe Kornizë Kushtetuese lidhur me emërimin e anëtarëve të Këshillit Drejtues të Institutit Gjyqësor të Kosovës (Emërimi i tetë anëtarëve të propozuar është miratuar me shumicë votash për.)

---

maj, 19 qershor, 3, 5 dhe 10 korrik. Dëgjimin publik lidhur me sulmet kundër agjencive të pavarura më 16 maj, dëgjimin publik lidhur me zbatimin Ligjit për Kinematografinë më 17 maj dhe dëgjimin publik lidhur me vlerësimin e projektligjit për ndërmarrjet më 28 maj.

<sup>3</sup> Përveç nëse është bërë e ditur në ndonjë mënyrë tjetër në këtë raport, kjo është shifra e njoftuar nga Kryetari i Kuvendit apo Kryesuesi në fillim të ditës.

- Shqyrtimi i rekomandimit të Komisionit për ekonomi, tregti, industri, energji, transport dhe komunikacion për kthimin e projektligjit për ndryshimin e ligjit për energji në Qeveri (Projektligji i është kthyer Qeverisë me 48 vota për dhe tri vota kundër. Shiko më poshtë paragrafin e dytë të pjesa “Procesi legjislativ”).
- Shqyrtimi i rekomandimit të Komisionit për ekonomi, tregti, industri, energji, transport dhe komunikacion për kthimin e projektligjit për ndryshimin e ligjit për rregullatorin e energjisë në Qeveri (Projektligji i është kthyer Qeverisë me 53 vota për dhe pesë vota kundër. Shiko më poshtë paragrafin e dytë të pjesa “Procesi legjislativ”).
- Shqyrtimi i rekomandimit të Komisionit për ekonomi, tregti, industri, energji, transport dhe komunikacion për kthimin e projektligjit për adaptimin konventës së Këshillit të Evropës kundër krimit kibernetik në Qeveri (Projektligji i është kthyer Qeverisë me 53 vota për dhe pesë vota kundër. Shiko më poshtë paragrafin e dytë të pjesa “Procesi legjislativ”).

**Seancën plenare të Kuvendit të Kosovës të mbajtur më 21 qershor** e kryesoi Kryetari i Kuvendit Kolë Berisha (LDK) dhe anëtari i Kryesisë z. Bislim Hoti (IRDK).

- Shtatëdhjetë e një deputetë ishin të pranishëm në seancën plenare të 21 qershorit.
- Pikat kryesore të rendit të ditës të seancës plenare të 21 qershorit:
  - Pyetjet për Qeverinë për përgjigje me gojë
  - Interpelanca e PDK-së për Ministrin për energji dhe miniera (Shiko më poshtë pjesën e titulluar “Interpelanca”).
  - Shqyrtimi i parë i projektligjit për barnat narkotike, psikotrope dhe prekursorë (Projektligji është miratuar në parim me 59 vota për dhe një votë kundër.)
  - Shqyrtimi i parë i projektligjit për dokumentet e udhëtimit (Projektligji është miratuar në parim me 63 vota për dhe një votë kundër.)
  - Shqyrtimi i parë i projektligjit Nr 2003/15 për ndryshimin e Ligjit për skemën e asistencës sociale (Projektligji është miratuar në parim me 52 vota për dhe shtatë vota kundër.)
  - Shqyrtimi i parë i projektligjit për rehabilitimin dhe punësimin e personave me aftësi të kufizuara (Projektligji është miratuar në parim me 61 vota për dhe pa vota kundër.)
  - Shqyrtimi i dytë i projektligjit për ushqimin (Projektligji është shtyrë me kërkesë të komisionit funksional. Shiko më poshtë paragrafin e parë të pjesa “Procesi legjislativ”).
  - Shqyrtimi i dytë i projektligjit për ndryshimin e Ligjit për likuidimin dhe riorganizimin e personave ligjor në falimentim (Projektligji është miratuar me 63 vota për dhe pa vota kundër.)
  - Rekomandimi i komisionit për çështje gjyqësore, legjislative dhe Kornizë Kushtetuese për miratimin e Rregullores për emërimin e Avokatit të Popullit (Rregullorja për emërimin e Avokatit të Popullit është miratuar me 52 vota për dhe katër vota kundër.)

**Seancën plenare të Kuvendit të Kosovës të mbajtur më 28-29 qershor** e kryesoi Kryetari i Kuvendit Kolë Berisha (LDK) dhe anëtari i Kryesisë z. Xhavit Haliti (PDK).

- Gjashtëdhjetë e gjashtë dhe 65 deputetë ishin të pranishëm në seancë më 28, përkatësisht 29 qershor.
- Pikat kryesore të rendit të ditës të seancës plenare të 28-29 qershorit:
  - Pyetjet për Qeverinë për përgjigje me gojë
  - Debatimi për regjistrimin e popullsisë

- (Z. Alush Gashi (LDK) si sponsorues i debatit bëri deklaratën hyrëse pasuar nga Ministria për Shërbime Publike Melihate Tërmkolloi, deklaratat në emër të grupeve parlamentare, disa deputetë dhe deklarata përmbyllëse nga z. Gashi.)
- Debati për rininë  
Z. Jakup Krasniqi (PDK) si sponsorues i debatit bëri deklaratën hyrëse pasuar nga Ministri për Kulturë, Rini dhe Sport Astrit Haraçija, deklaratat në emër të shefave të grupeve parlamentare, disa deputetë të tjerë dhe deklarata përmbyllëse nga z. Krasniqi.)
  - Debati për zbatimin e rekomandimeve të Kuvendit të datës 7 korrik 2005 lidhur me pensionet e pleqërisë  
(Znj. Fatmire Mulhaxha-Kollçaku (ORA) si sponsoruese e debatit bëri deklaratën hyrëse pasur nga Ministri për Punë dhe Mirëqenie Sociale Ibrahim Selmanaj, deklaratat në emër të shefave të grupeve parlamentare, disa deputetë të tjerë dhe deklarata përmbyllëse e znj. Mulhaxha-Kollçaku.)
  - Debati për ndërtimet ilegale të ndërtesave nga Qeveria e Serbisë në pjesën veriore të Mitrovicës/Mitrovica  
(Kjo pikë është hequr nga rendi i ditës. Shiko më poshtë pjesën e titulluar “Rendi i ditës”).)
  - Shqyrtimi i dytë i projektligjit për ndërtimet ilegale  
(Shqyrtimi i projektligjit është shtyrë me kërkesë të komisionit funksional. Shiko më poshtë paragrafin e parë të pjesa “Procesi legjislativ”).)
  - Shqyrtimi i dytë i projektligjit për ndryshimin e Ligjit për planifikimin hapësinor  
(Projektligji është miratuar me 56 vota për dhe pa vota kundër.)
  - Shqyrtimi i rekomandimit të Komisionit për ekonomi, tregti, industri, energji, transport dhe komunikacion lidhur me liçencimin e kompanisë për hulumtime “Kosovo Resource”  
(Rekomandimet janë miratuar me 66 vota për dhe pa vota kundër.)

**Seancën plenare të Kuvendit të Kosovës të mbajtur më 12 korrik** e kryesoi Kryetari i Kuvendit Kolë Berisha (LDK) dhe anëtari i Kryesisë z. Xhavit Haliti (PDK).

- Shtatëdhjetë e tre deputetë ishin të pranishëm në seancën plenare të 12 korrikut.
- Pikat kryesore të rendit të ditës të seancës plenare të 12 korrikut:
  - Pyetjet për Qeverinë për përgjigje me gojë
  - Shqyrtimi i parë i projektligjit për shitjen e banesave në të cilat ekziston e drejta banesore  
(Projektligji është miratuar në parim me 69 vota për dhe dy vota kundër.)
  - Shqyrtimi i parë i projektligjit për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik  
(Projektligji është miratuar në parim me 66 vota për dhe katër vota kundër.)
  - Shqyrtimi i parë i projektligjit për organizmat e modifikuar gjenetiksht  
(Projektligji është miratuar në parim me 60 vota për dhe gjashtë vota kundër.)
  - Shqyrtimi i parë i projektligjit për ndryshimin e Ligjit Nr 2003/11 për rrugët  
(Kjo pikë është shtyrë për shkak të mungesës së sponsoruesit, Minsitri për transport dhe telekomunikacion”).)
  - Shqyrtimi i rekomandimit të Komisionit për arsim, shkencë, teknologji, kulturë, rini dhe sport lidhur me emërimin e anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Shkencës  
(Emërimi i të gjithë kandidatëve të propozuar është miratuar me 40 vota për dhe 15 votakundër.)
  - Shqyrtimi i amandamenteve të propozuara në Rregulloren e Punës  
(Amandamentet e propozuara në Rregulloren e Punës janë miratuar në parim me 55 vota për dhe 18 vota kundër. Shiko më poshtë pjesën e titulluar “Miratimi në parim i amendamenteve në Rregulloren e Punës”).)

### 3. Punimet dhe praktikat parlamentare në seancat e Kuvendit

#### Rendi i ditës

- Në fillim të seancës plenare të 21 qershorit, Kryetari i Kuvendit lajmëroi se për ndryshimin e rendit të ditës në pajtim me rregullën 23.2 ishin paraqitur tri propozime *me shkrim* para fillimit të seancës plenare. Ai deklaroi se grupi parlamentar Për Integrim kishte propozuar që diskutimi për tejkalimin e kompetencave nga Grupi i Unitetit të futet në rendin e ditës, dhe e hedhi në votim propozimin e grupit Për Integrim, i cili është refuzuar me 9 vota për, 29 vota kundër dhe katër abstenime. Kryetari i Kuvendit vazhdoi se Komisioni për bujqësi, pylltari, zhvillim rural, ambient dhe planifikim hapësinor, dhe Komisioni për shëndetësi, punë dhe mirëqenie sociale kishin propozuar heqjen nga rendi i ditës i shqyrtimit të dytë të projektligjit për ushqimin dhe e hedhi në votim propozimin, i cili është miratuar me shumicë votash për dhe pa vota kundër. Ai shtoi se Komisioni për çështje gjyqësore, legjislativë dhe Kornizë Kushtetuese kishte propozuar që në rendin e ditës të futej shqyrtimi i Rregullores së ripunuar për emërimin e Avokatit të Popullit dhe e hedhi në votim propozimin, i cili është miratuar me shumicë votash për dhe pa vota kundër.

Në fillim të seancës plenare të 28 qershorit, Kryetari i Kuvendit lajmëroi se Komisioni për bujqësi, pylltari, zhvillim rural, ambient dhe planifikim hapësinor, si komision funksional, kishte kërkuar *me shkrim* heqjen nga rendi i ditës në fjalë shqyrtimin e dytë të projektligjit për ndërtimet ilegale, dhe e hedhi në votim propozimin i cili është miratuar me shumicë votash për dhe një votë kundër. Në po atë seancë në emër të grupit parlamentar të AAK-së znj. Gjylnaze Sylja gjithashtu propozoi *me shkrim* që pika e rendit të ditës – debati për ndërtimet ilegale të ndërtesave nga Qeveria e Serbisë në pjesën veriore të Mitrovicës – të heqej nga rendi i ditës për shkak të mungesës së informacionit lidhur me këtë çështje. Kryetari i Kuvendit e hedhi në votim propozimin e znj. Sylja, i cili është miratuar me 32 vota për dhe 17 vota kundër.

Në fillim të seancës plenare të 12 korrikut, në emër të grupit parlamentar ORA, z. Nazim Jashari propozoi *gojarisht* që pika e rendit të ditës – amendamentet e propozuara në Rregulloren e Punës – të heqej nga rendi ditës me arsyetimin se për t'i proceduar këto amandamente duhet të formohej një komision i posaçëm. Kryetari i Kuvendit e hedhi në votim propozimin e z. Jashari i cili është refuzuar me 33 vota për, 38 vota kundër dhe gjashtë abstenime.

*Rregullat e reja 23.1-2 parashohin që “Kryesia përgatitë një propozim të rendit të ditës për seancën e radhës të Kuvendit dhe menjëherë të njëjtin e vë në dispozicion për deputetët e Kuvendit. Në fillim të seancës ky propozim rend dite do të konsiderohet i miratuar, përveç nëse një ose më shumë grupe parlamentare apo 6 deputetë i propozojnë me shkrim Kryetarit një amendament në rendin e ditës, i cili hidhet në votim.” Të gjitha propozimet për ndryshimin e rendeve të ditës të seancave plenare gjatë periudhës raportuese, përveç propozimit të z. Jashari, janë bërë në pajtim me rregullat e reja, që paraqet përmirësim në krahasim me periudhat e mëparshme raportuese. Qëllimi i ripunimit të dispozitave lidhur me përgatitjen e rendit të ditës në seancën plenare të 1 qershorit 2006 ishte që ta bëjë punën e Kuvendit më të efektshme dhe më të rregullt, por edhe pas ripunimit të dispozitave lidhur me rendin e ditës, deputetëve u është lejuar që të bëjnë propozime gojore lidhur me rendin e ditës<sup>4</sup> siç përshkruhej në rregullën e vjetër, e cila më nuk është në fuqi. Dispozitat e reja, të cilat kërkojnë që propozimet lidhur me rendin e ditës të parashtrihen *me shkrim*, duhet të respektohen në mënyrë të vazhdueshme në mënyrë që të shmanget paqartësia dhe që punimet e Kuvendit të jenë më të rregullta.*

#### Miratimi në parim i amandamenteve në Rregulloren e Punës

- Gjatë seancës plenare të 12 korrikut Kryetari i Kuvendit njoftoi se plani i parë i standardeve i miratuar në seancën plenare të 1 qershorit 2006<sup>5</sup> ishte një pjesë e reformave gjithëpërfshirëse dhe e paraqiti pjesën e dytë të planit të standardeve që përfshin disa amandamente në

<sup>4</sup> Shiko raportet 02/2007, 01/2007, 07/2006, 06/2006 dhe 05/2006 të shtyllës III (OSBE) mbi monitorimin e Kuvendit të Kosovës, pjesën e titulluar “Rendi i ditës”.

<sup>5</sup> Shiko raportin 04/2006 të shtyllës së III-të (OSBE) mbi monitorimin e Kuvendit të Kosovës, pjesën e titulluar “Miratimi i ndryshimeve në Rregulloren e Punës”.

Rregulloren e Punës. Ai shtoi se plotësimi i planit të standardeve është paraqitur në pajtim me rregullën 58.1 dhe është bërë për të përmirësuar efikasitetin në përgatitjen dhe miratimin e rendeve të ditës të seancave plenare dhe për të rritur transparencën duke publikuar punët e rregullta të Kuvendit, përfshirë mocionet, rezolutat, projektligjet, procesverbalet dhe transkriptet nga seancat plenare. Në emër të LDK-së z. Sabri Hamiti i mbështeti amendamentet e propozuara nga Kryesia. Z. Hydajet Hyseni (PDK) deklaroi se grupi i tij parlamentar i përkrah amendamentet në Rregulloren e Punës dhe propozoi që amendamentet të miratohen në dy shqyrtime, sikur projektligjet në mënyrë që deputetëve që dëshirojnë të propozojnë amendamente tjera t'u lejohet ta bëjnë këtë. Ai poashtu propozoi që ose komisioni *ad hoc* për Rregulloren e Punës të rithemelohej ose Komisioni për çështje gjyqësore, legjislative dhe Kornizë Kushtetuese të ngarkohet për shqyrtimin e amendamenteve të propozuara nga Kryesia dhe t'i paraqesë amendamentet përfundimtare Kuvendit për miratim. Znj. Gjylnaze Sylja (AAK) poashtu i mbështeti amendamentet në Rregulloren e Punës dhe propozoi që amendamentet të miratohen në parim gjatë seancës në fjalë. Ajo poashtu u pajtua që Komisioni për çështje gjyqësore, legjislative dhe Kornizë Kushtetuese të ngarkohet për paraqitjen e amendamenteve përfundimtare në Kuvend për miratim. Z. Gazmend Muhaxheri (ORA) gjithashtu e mbështeti ndryshimin e Rregullores së Punës dhe propozoi që Kuvendi të themelojë një komision *ad hoc* për t'u marrë me këtë. Z. Ramadan Kelmendi (LDD) pohoi se amendamentet në Rregulloren e Punës mund të miratohen edhe gjatë seancës në fjalë meqë Kryesia i kishte propozuar ato në pajtim me vetë Rregulloren. Kryetari i Kuvendit e ka hedhur në votim propozimin për miratimin në parim të amendamenteve në Rregulloren e Punës dhe ka njoftuar se Kryesia do t'i shqyrtonte amendamentet e mundshme shtesë të propozuara nga deputetët dhe do t'i paraqiste amendamentet përfundimtare Kuvendit për miratim. Amendamentet janë miratuar në parim me 55 vota për dhe 18 vota kundër.

*Rregulla 58.1 parasheh që “Kryesia e shqyrton vazhdimisht Rregulloren e punës dhe kohë pas kohe mund t'i propozojë Kuvendit ndryshime, që mendon se janë të nevojshme” Andaj, Kryesia i ka propozuar amendamentet në Rregulloren e Punës në pajtim me vetë Rregulloren. Rregulla 3.4 parasheh që Kuvendi në seancën konstituive ose në mbledhjen tjetër të radhës, do ta formojë një komision ad hoc, i cili përgatit projektin e Rregullores së Punës dhe ia paraqet Kuvendit për shqyrtim dhe miratim. Megjithatë, Rregullorja nuk e rregullon përfshirjen e komisionit në amendamentimin e mëvonshëm të Rregullores së Punës. Kështuqë, Kuvendi ka mundur të vendosë ta ri-themelojë Komisionin ad hoc për Rregulloren e Punës për t'i hartuar amendamentet pasiqë një procedurë e tillë nuk ndalohej me Rregullore. Rregullorja gjithashtu nuk e parasheh rolin e Komisionit për çështje gjyqësore, legjislative dhe Kornizë Kushtetuese në propozimin dhe shqyrtimin e amendamenteve në Rregulloren e Punës. Ekziston një precedent i vendosur nga Kuvendi i mëparshëm, i cili, edhe pse nuk ishte e paraparë në Rregulloren e tij, i kishte dhënë për detyrë Komisionit për çështje gjyqësore, legjislative dhe Kornizë Kushtetuese të propozojë amendamente në Rregulloren e Punës. Sidoqoftë, një precedent i vendosur nga Kuvendi i mëparshëm nuk e obligon Kuvendin aktual.*

*Nuk ekzistojnë dispozita të cilat në mënyrë të prerë shpjegojnë nëse amendamentimi i Rregullores së Punës mund të bëhet në dy shqyrtime apo jo, andaj vendimi i Kuvendit për amendamentimin e Rregullores së Punës në dy shqyrtime nuk paraqet shkelje të Rregullores. Amendamentet në Rregulloren e Punës të propozuara nga Kryesia dhe të miratuara nga Kuvendi në seancën plenare të 1 qershorit 2006 nuk janë shqyrtuar në dy lexime, por procedura e shqyrtimit si e tillë nuk është prerazi e ndaluar. I takon Kuvendit që të vendosë lidhur me mënyrën e amendamentimit të Rregullores së tij të Punës. Rregula 58.3 parasheh që vendimi për amendamentimin e Rregullores së Punës merret nga Kuvendi me shumicë votash të deputetëve të Kuvendit, që do të thotë se një vendim i tillë duhet të merrë të paktën 61 vota për. Miratimi në parim i amendamenteve në Rregulloren e Punës ka marrë 55 vota për dhe si i tillë nuk paraqet shkelje procedurale. Por, miratimi i amendamenteve në Rregulloren e Punës duhet të merrë përkrahjen e të paktën 61 deputeti të Kuvendit. Kështuqë, është e këshillueshme që Kuvendi aktual ta qartësojë procedurën për shqyrtimin dhe miratimin e amendamenteve në Rregulloren e Punës, gjë që mund të jetë shumë e dobishme për Kuvendin e ardhshëm.*

### Kryesimi seancave plenare

- Në seancën plenare të 30 majit, gjatë debatit për raportin e punës së Qeverisë për vitin 2006, z. Naser Osmani (LDK) bëri vërejtjen që z. Gazmend Muhaxheri (ORA) po e kryesonte seancën gjatë asaj kohe duke pohuar se seancat plenare duhet të kryesohen ose nga Kryetari i Kuvendit ose nga anëtari i Kryesisë nga LDK-ja. Z. Muhaxheri u përgjigj se Kryetari i Kuvendit i kishte dy takime të rëndësishme atë ditë dhe shpjegoi se në mungesë të Kryetarit seanca plenare kryesohet nga anëtari i Kryesisë i zgjedhur për t'i ndihmuar Kryetarit të Kuvendit gjatë kryesimit të seancës së njëjtë. Ai poashtu shtoi se për këtë arsye anëtari i Kryesisë nga LDK-ja nuk mund ta kryesonte seancën në fjalë.

*Si Korniza Kushtetuese ashtu edhe Rregullorja e Punës së Kuvendit nuk parashohin që Kryetari i Kuvendit duhet të ndihmohet nga anëtari i Kryesisë nga e njëjta parti me Kryetarin gjatë kryesimit të seancave plenare. Për më tepër, rregulla 10 parashih që “në udhëheqjen e punës së seancave të Kuvendit, Kryetarit i ndihmon njëri nga anëtarët e Kryesisë së Kuvendit, sipas radhës së caktuar nga Kryesia.” Është e qartë se përkatësia politike e anëtarëve të Kryesisë është jo relevante në këtë rast. Andaj, është e drejtë vetëm e Kryesisë të vendosë se cili nga anëtarët e saj do ta ndihmojë Kryetarin gjatë kryesimit të seancës plenare.*

### Shpërndarja e projektligjeve

- Projektligji për statusin civil dhe projektligji për ndryshimin e Ligjit Nr 46/2004 për regjistrat e statusit civil u janë shpërndarë deputetëve më 2 maj, derisa projektligji për ndryshimin e Ligjit Nr 2004/1 mbi transportin rrugor është shpërndarë më 4 maj. Andaj, projektligjet janë shpërndarë 20, përkatësisht 18 ditë pune para shqyrtimit të tyre të parë në seancën plenare të 31 majit. Projektligji për substancat narkotike, psikotrope dhe prekursorë është shpërndarë më 7 maj, derisa projektligji për ndryshimin e Ligjit Nr. 2003/15 për skemën e ndihmës sociale është shpërndarë më 25 maj. Projektligji për dokumentat e udhëtimit dhe projektligji për rehabilitimin dhe punësimin e personave me aftësi të kufizuara janë shpërndarë më 1 qershor. Andaj, projektligjet janë shpërndarë 31, 18, përkatësisht 13 ditë pune para shqyrtimit të tyre të parë në seancën plenare të 21 qershorit. Projektligji për shitjen e banesave në të cilat ekziston e drejta banesore është shpërndarë më 11 qershor, projektligji për parandalimin e konfliktit të interesit gjatë ushtrimit të detyrës zyrtare është shpërndarë më 14 qershor, projektligji për organizmat e modifikuar gjenetikisht është shpërndarë më 20 qershor, dhe projektligji Nr.2003/11 për ndryshimin e ligjit për rrugët është shpërndarë më 27 qershor. Andaj, projektligjet janë shpërndarë 22, 19, 15, përkatësisht dhjetë ditë pune para shqyrtimit të tyre të parë në seancën plenare të 12 korrikut.

*Projektligji për dokumentat e udhëtimit, projektligji për rehabilitimin dhe punësimin e personave me aftësi të kufizuara dhe projektligji për organizmat e modifikuar gjenetikisht janë shqyrtuar në lexim të parë në pajtim me rregullën 35.1, e cila kërkon që shqyrtimi i parë i projektligjit të bëhet jo më parë se dhjetë ditë pune dhe as më shumë se tri javë pune nga dita e shpërndarjes së tij. Leximi i parë i projektligjit Nr.2003/11 për ndryshimin e Ligjit për rrugët është caktuar në pajtim me rregullën 35.1, por nuk është shqyrtuar për shkak të mungesës së Ministrisë për transport dhe telekomunikacion, i cili e ka sponsoruar ligjin në fjalë dhe duhej ta paraqiste para Kuvendit. Kjo thekson nevojën për bashkërendim më të mirë në mes të Qeverisë dhe Kuvendit në mënyrë që të mos shtyhet shqyrtimi dhe miratimi i projektligjeve.*

*Projektligji për statusin civil, projektligji për ndryshimin e Ligjit Nr 46/2004 për regjistrat e statusit civil, projektligji për ndryshimin e Ligjit Nr 2004/1 për transportin rrugor, projektligji për substancat narkotike, psikotrope dhe prekursorë, projektligji për ndryshimin e Ligjit Nr. 2003/15 për skemën e ndihmës sociale, projektligji për shitjen e banesave në të cilat ekziston e drejta banesore dhe projektligji për parandalimin e konfliktit të interesit gjatë ushtrimit të detyrës zyrtare janë shqyrtuar për herë të parë pas tri javë pune nga data e shpërndarjes së tyre, gjë që nuk është në pajtim me rregullën e lartshënuar. Kjo tregon se Kuvendi ende ka vështirësi në shqyrtimin e projektligjeve brenda afatit të paraparë në Rregullore, edhe përkundër faktit se mban seanca plenare dy herë në muaj. I rekomandohet Kuvendit që së*

*shpejti të vendosë se si t'i procedojë gjatë pjesës së mbetur të mandatit projektligjet e mbetura në procedurë. Nëse Kuvendi dëshiron ta shpejtojë shqyrtimin dhe miratimin e projektligjeve që janë ende në procedurë, atëherë mund t'i kthehet sistemit të mbajtjes së seancave plenare çdo javë.*

#### Procesi legjislativ

- Projektligji për ndryshimin e Ligjit për likuidimin dhe riorganizimin e personave ligjor në falimentim është miratuar gjashtë muaj pas shqyrtimit të parë më 21 dhjetor 2006. Projektligji për ndryshimin e Ligjit Nr. 2003 për planifikimin hapësinor është miratuar më shumë se tre muaj pas shqyrtimit të parë më 16 mars 2007. Shqyrtimi i dytë i projektligjit për ndërtimet ilegale ishte caktuar më shumë se gjashtë muaj pas shqyrtimit të parë më 14 dhjetor 2006, derisa shqyrtimi i dytë i projektligjit për ushqimin ishte caktuar më shumë se 19 muaj pas shqyrtimit të parë më 17 nëntor 2005.

*Kjo nuk është pajtim me rregullën 35.6 e cila parasheh që “Në rastet kur një komision është caktuar ta shqyrtojë projektligjin, atëherë ai i raporton rekomandimet e veta në Kuvend, por jo më vonë se dy muaj nga shqyrtimi i parë i projektligjit, përveç rasteve kur është miratuar një kohëzgjatje shtesë nga Kuvendi”. Komisionet e Kuvendit i kanë paraqitur rekomandimet e tyre në të gjitha projektligjet e lartpërmendura me një vonesë të konsiderueshme nga afati i përcaktuar me rregullën 35.6, pa kërkuar nga Kuvendi shtyerjen e afatit. Nëse Kuvendi dëshiron ta rrisë efektivitetin e procesit të tij legjislativ, komisionet duhet t'i shqyrtojnë projektligjet brenda kohës së paraparë në rregullën e lartëshënuar.*

- Në seancën plenare të 31 majit, Ministri për ambient dhe planifikim hapësinor Ardian Gjini ka kërkuar të tërhiqet projektligji për vlerësimin e ndikimit në mjedis, të sponsoruar nga ministria e tij, nga shqyrtimi i parë me arsyetimin se projektligji duhet të plotësohej më tej. Andaj, projektligji në fjalë është tërhequr. Në të njëjtën seancë plenare, Komisioni për çështje gjyqësore, legjislative dhe Kornizë Kushtetuese bëri kërkesë për kthimin e projektligjit për ndërmjetësimin në Qeveri për shqyrtim të mëtutjeshëm, dhe Komisioni për ekonomi tregti, industri, energji, transport dhe komunikacion bëri kërkesë për kthimin e projektligjeve në vijim në Qeveri për shqyrtim të mëtutjeshëm: Projektligji për ndryshimin e Ligjit Nr. 2004/08 për energji, projektligji për ndryshimin e Ligjit Nr. 2004/09 për rregullatorin e energjisë dhe projektligji për adoptimin e konventës së Këshillit të Evropës kundër krimit kibernetik. Kryetari i Kuvendit e hedhi në votim secilin propozim, të cilët janë miratuar me shumicë votash për. Projektligji për ndërmjetësimin është miratuar në parim në seancën plenare të 20 janarit 2006, derisa projektligji për adoptimin e konventës së Këshillit të Evropës kundër krimit kibernetik, Projektligji për ndryshimin e Ligjit Nr. 2004/08 për energji, dhe projektligji për ndryshimin e Ligjit Nr. 2004/09 për rregullatorin e energjisë janë miratuar në parim në seancën plenare të 31 gushtit 2006. Andaj, projektligjet i janë kthyer Qeverisë 16, përkatësisht nëntë muaj pas shqyrtimit të tyre të parë.

*Ministri për ambient dhe planifikim hapësinor e ka tërhequr projektligjin për vlerësimin e ndikimit në mjedis në pajtim me rregullën 35.3 e cila parasheh që “Propozuesi mund ta tërheqë projektligjin gjatë shqyrtimit të parë deri para fillimit të procedurës së votimit për miratim në parim.” Sipas interpretimit analogjik, edhe Komisioni për çështje gjyqësore, legjislative dhe Kornizë Kushtetuese dhe Komisioni për ekonomi tregti, industri, energji, transport dhe komunikacion është dashur t'i propozojnë Kuvendit që t'ia kthente projektligjet e lartpërmendura Qeverisë në pajtim me rregullën 35.3. Për më tepër rregulla 35.7 parasheh që “Komisioni funksional - përgjegjës raportues ose kryesor, mund ta shqyrtojë projektligjin në parim edhe para shqyrtimit të parë të projektligjit në seancë plenare.” Sikur Komisioni për çështje gjyqësore, legjislative dhe Kornizë Kushtetuese dhe Komisioni për ekonomi tregti, industri, energji, transport dhe komunikacion t'i kishin shqyrtuar projektligjet e lartpërmendura para leximit të parë, siç lejohet me rregullën 35.7, do t'i kishin vërejtur më herët lëshimet në këto projektligje dhe do të mund të propozonin kthimin e tyre ministrive sponsoruese gjatë leximit të parë në vend se të bëjnë një propozim të tillë gjashtëmbëdhjetë, përkatësisht nëntë*



*muaj pas miratimit në parim të projektligjeve në fjalë. I rekomandohet komisioneve ta shfrytëzojnë mundësinë e shqyrtimit të projektligjeve para leximit të parë në mënyrë që procesi legjislativ të bëhet më i efektshëm.*

### Interpelanca

- Më 15 maj, sekretari i përhershëm i Zyrës së Kryeministrit Agim Çeku i ka dërguar një letër Kryesisë ku ka deklaruar se Kryeministri është i gatshëm të paraqitet para Kuvendit në interpelancën e grupit parlamentar ORA lidhur me përzgjedhjen e anëtarëve të bordeve të ndërmarrjeve publike nga Qeveria.<sup>6</sup> Kryesia në mbledhjen e saj më 25 maj e ka radhitur interpelancën për debat në seancën plenare të 31 majit.

Në seancën plenare të 31 majit, Kryetari i Kuvendit ua përkujtoi deputetëve se sipas rregullës 25.7 grupi parlamentar që ka propozuar interpelancën për debat ka të drejtën ta hapë debatin me deklaratë dhjetë minutëshe dhe ta mbyll atë me deklaratë pesë minutëshe, derisa ndarja e kohës gjatë debatit do ta reflektojë përfaqësimin e secilit grup parlamentar në Kuvend. Znj. Teuta Sahatqija (ORA) e hapi interpelancën për debat duke deklaruar se ndërmarrjet publike janë një faktor i rëndësishëm që mund t'i kontribuojë zhvillimit ekonomik të Kosovës, por e kritikoi Qeverinë për emërimin e anëtarëve të lidhur me partitë nga koalicioni në bordet e ndërmarrjeve publike, në vend se të emërojë profesionistë, gjë që e pengon zhvillimin e ndërmarrjeve. Kryeministri u përgjigj se Qeveria ka të drejtë t'i propozojë kandidatët por Agjensioni Kosovar i Mirëbesimit (AKM) e ka autoritetin përfundimtar për emërimin e anëtarëve të bordeve të ndërmarrjeve publike, duke shtuar se kushtet e punësimit për këta anëtarë poashtu definoohen në rregulloret e brendshme të AKM-së. Disa deputetë nga grupe të ndryshme parlamentare bënë deklaratë para se interpelanca të mbyllej nga z. Veton Surroi (ORA) si sponsorues i interpelancës.

- Më 15 maj Ministri për energji dhe miniera Et'hem Çeku i ka dërguar një letër Kryesisë ku ka deklaruar se ishte i gatshëm që para Kuvendit t'i përgjigjet mocionit për interpelancë të PDK-së lidhur me liçencën për hulumtim dhënë kompanisë “Kosovo Resource” nga ana e Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale.<sup>7</sup> Kryesia në mbledhjen e saj më 14 qershor e ka radhitur interpelancën për debat për seancën plenare të 21 qershorit.

Në seancën plenare të 21 qershorit z. Jakup Krasniqi (PDK) e hapi interpelancën për debat duke deklaruar se resurset natyrore të Kosovës dhe prona publike po keqmenagjohen dhe po degradohen duke e dëmtuar kështu ekonominë e Kosovës, dhe shtoi se lëshimi i liçencës për hulumtim kompanisë “Kosovo Resource” nga ana e Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale (KPMM) është shembull tipik i këtij degradimi. Ministri u përgjigj se KPMM-ja vërtet e ka shkelur Rregulloren e UNMIK-ut 2005/3 gjatë lëshimit të kësaj liçence kompanisë në fjalë dhe se ministria e tij ka kërkuar shumë herë të kontaktojë me PSSP-në, shtyllën IV dhe AKM-në për ta diskutuar çështjen por nuk ka arritur t'i takojë. Ministri tha se vështirësia kryesore ishte se PSSP-ja akoma nuk e ka shpallur Ligjin për miniera dhe minerale<sup>8</sup> duke pohuar se sikur ky ligj të ishte shpallur dhe sikur të ishte në fuqi, problemet lidhur me lëshimin e liçencës për hulumtimin e minierave do të zgjidhej. Disa deputetë nga parti të ndryshme bënë deklaratë para se interpelanca të mbyllej nga z. Krasniqi

*Debati mbi interpelancat është bërë në pajtim me rregullën e re 25.7 sipas të cilës grupi parlamentar që ka propozuar interpelancën ka të drejtë ta hapë debatin me deklaratë dhjetë*

<sup>6</sup> Më 18 prill grupi parlamentar ORA ka parashtruar një mocion për interpelancë ku ka ftuar Kryeministrin Agim Çeku t'i shpjegojë “kriteret për zgjedhjen nga ana e Qeverisë të anëtarëve të bordeve të ndërmarrjeve publike.” Më 7 maj Kryesia ia ka përcjellur mocionin për interpelancë Qeverisë. Shiko paragrafin e tretë të titulluar “Interpelanca” të raportit 02/2007 të shtyllës së III-të (OSBE) mbi monitorimin e Kuvendit të Kosovës.

<sup>7</sup> Më 11 prill grupi parlamentar i PDK-së ka parashtruar një mocion për interpelancë ku ka ftuar ministrin për energji dhe miniera Et'hem Çeku të shpjegojë lëshimin e liçencës për hulumtim kompanisë “Kosovo Resource” nga ana e Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale. Më 7 maj Kryesia ia ka përcjellur mocionin për interpelancë Qeverisë. Shiko paragrafin e dytë të titulluar “Interpelanca” të raportit 02/2007 të shtyllës së III-të (OSBE) mbi monitorimin e Kuvendit të Kosovës.

<sup>8</sup> Ligji për minierat dhe mineralet është miratuar nga Kuvendi në seancën plenare të 19 janarit 2006 dhe ende pret shpalljen nga PSSP-ja.

minutëshe dhe ta mbyll atë me deklaratë pesë minutëshe, derisa ndarja e kohës gjatë debatit e reflekton përfaqësimin e secilit grup parlamentar në Kuvend.

Sipas rregullave të reja 25.5-6 “Kryesia e Kuvendit, menjëherë sapo ta ketë marrë tekstin e interpelancës, ia dërgon Qeverisë, e cila është e detyruar ta shqyrtojë brenda shtatë (7) ditësh. Interpelanca vihet në rendin e ditës në afatin prej shtatë (7) ditësh, pasi të merret përgjigja nga Qeveria. Në qoftë se Qeveria në afatin e paraparë me paragrafin 5 nuk e dërgon përgjigjen lidhur me interpelancën, interpelanca vihet si pikë e fundit në rendin e ditës të seancës plenare që është duke u zhvilluar. Nëse Kuvendi nuk është për seancë, atëherë ajo vihet si pikë e parë në rendin e ditës së seancës së parë të radhës të Kuvendit.” Kryeministri dhe Ministri për Energji dhe miniera i kanë dërguar përgjigjet e tyre brenda afatit të paraparë në rregullën 25.5, por Kryesia e ka caktuar debatin për interpelancën e ORA-s dhe PDK-së dy, përkatësisht pesë javë pas marrjes së përgjigjes nga Qeveria, gjë që nuk është në pajtim me rregullën e re 25.6. Kryesia është takuar dhjetë ditë pas marrjes së përgjigjes nga Kryeministri dhe Ministri për energji dhe miniera, që ka rezultuar me caktimin e interpelancave për debat më vonë nga ç’është e paraparë në rregullën e re 25.6. Sikur Kryesia të ishte takuar më herët, edhe propozimet për interpelancë do të ishin caktuar për debat më herët.

- Më 26 qershor, grupi parlamentar ORA ka parashtruar një mocion për interpelancë për Kryeministrin Agim Çeku lidhur me “dështimin e Kryeministrit në zbatimin e dispozitës 3.4 të dokumentacionit të tenderit për liçencimin e operatorit të dytë të telefonisë mobile, sipas të cilës është dashur të konfiskohen 1.6 milion Euro nga fituesi i parë i përzgjedhur, siç parashihet në nenin 55.1 (c-ii) të Ligjit për prokurim publik, e që drejtpërdrejt ka ndikuar në buxhetin e Kosovës.” Në mocionin e saj, ORA ka rekomanduar që “të formohet një komision parlamentar hetimor për të hetuar përgjegjësinë e të gjithë atyre që e kanë shkelur ligjin dhe rregullat në procesin tenderues.” Kryesia, në mbledhjen e mbajtur më 5 korrik, ka vendosur që t’ia përcjell mocionin për interpelancë Qeverisë. Mocioni për interpelancë është parashtruar pranë Zyrës së Kryeministrit më 10 korrik. Më 16 korrik, Sekretari i përhershëm në Zyrën e Kryeministrit Agim Çeku i ka dërguar një letër Kryesisë ku ka deklaruar se Kryeministri gjithmonë ka treguar gatishmëri për t’u përgjigjur para Kuvendit në mocionet për interpelancë drejtuar atij, por se në këtë rast ai nuk do të jetë në gjendje ta bëjë këtë sepse çështja është në autoritetin e Agjencionit Rregullator të Telekomunikacionit (ART). Letra më tutje shpjegonte se ART-ja është e obliguar t’i raportojë Kuvendit në pajtim me Ligjin për telekomunikacion dhe sugjeronte që mocioni për interpelancë t’i drejtohet ART-së.

Në mbledhjen e Kryesisë të mbajtur më 20 korrik, znj. Teuta Sahatqija (ORA) ka insistuar që Kryeministri të përgjigjet në interpelancë në seancën e radhës. Z. Xhavit Haliti (PDK) poashtu deklaroi se Kryeministri duhet t’i përgjigjet mocionit për interpelancë të ORA-s në Kuvend, dhe pohoi se lëshimi i liçencës operatorit të dytë të telefonisë mobile është kompetencë e Qeverisë e jo e ART-së. Kryesia e radhiti interpelancën për debat në seancën plenare të 27 korrikut.

Rregulla e re 25.8 parasheh që “Kryeministri ose ministri të cilit i parashtrohet interpelanca ka për detyrë ta paraqesë dhe arsyetojë qëndrimin e Qeverisë lidhur me çështjen e shtruar në interpelancë. Më tutje, si Rregullorja e punës së Kuvendit ashtu edhe Rregullorja e Qeverisë<sup>9</sup> nuk i japin të drejtën Qeverisë ta refuzojë mocionin për interpelancë. Ngjashëm, Kryesisë së Kuvendit i kërkohet sipas rregullës së re 25.6 ta radhisë mocionin për interpelancë për debat në seancë plenare, pa të drejtë ta bllokojë mocionin. Vetëm Kuvendi si tërësi mund ta bëjë këtë, ashtu siç është e paraparë në rregullën e re 25.6, “Kuvendi nuk mund ta refuzojë vënien e interpelancës për shqyrtim në rendin e ditës, përveç në rast se ajo nuk i plotëson kushtet formale sipas paragrafit 4 të kësaj rregulle.”<sup>10</sup>

<sup>9</sup> Neni 71 i Rregullores së punës së Qeverisë parasheh që “sa herë që Kuvendi debaton mocionin e votëbesimit të Qeverisë, propozimet për emërim apo shkarkim të ministrave ose interpelancën për punën e Qeverisë, Qeverinë në Kuvend e përfaqëson Kryeministri. Rregullorja e punës së Qeverisë më tutje nuk bën fjalë për interpelancat.

<sup>10</sup> Paragrafi 4 i rregullës së re 25 parasheh që “Mocioni për interpelancë parashtrohet në formë të shkruar dhe përmban: a) Formulimin e saktë të çështjes që është lëndë e interpelancës; b) arsyetimin për mocionin; dhe c) emrin dhe mbiemrin e deputetit, që e ka parashtruar interpelancën në Kuvend.

## Pyetjet për Qeverinë

- Në seancën plenare të 31 majit, 11 prej 14 pyetjeve morën përgjigje. Në seancën plenare të 21 qershorit, gjashtë nga 13 pyetje morën përgjigje. Në seancën plenare të 28-29 majit, katër prej dhjetë pyetjeve morën përgjigje. Në seancën plenare të 12 korrikut dy prej shtatë pyetjeve morën përgjigje. Në po atë seancë, z. Ramadan Kelmendi (LDD) bëri vërejtjen se dy pyetje që ai i kishte parashtruar për Ministrin e Pushtetit Lokal Lutfi Haziri më 21 mars 2007, nuk kishin marrë përgjigje ende dhe insistoi që të merrte përgjigje nga Ministri. Në secilën prej seancave të mbuluara në këtë raport, Kryetari i Kuvendit ose anëtari i Kryesisë që kryesonte seancën është përgjigjur se pyetjet të cilat nuk marrin përgjigje brenda dy seancave plenare do të publikohen në buletin e Kuvendit. Gjatë periudhës raportuese pesë pyetje janë shtyrë për shkak të mungesës së deputetëve në seancat plenare dhe 16 pyetje janë shtyrë për shkak të mungesës së Ministrave.

*Koha për pyetjet parlamentare është kryer në pajtim me rregullën e re 26 për “Pyetjet për Qeverinë për përgjigje me gojë”, e cila parasheh që rendi i ditës i secilës seancë plenare duhet të përfshijë kohën deri në 50 minuta për pyetjet e deputetëve për Qeverinë, ku një minutë zgjat pyetja, tre minuta përgjigja e Ministrin, një minutë pyetja shtesë dhe dy minuta përgjigja në pyetjen shtesë.*

*Sipas rregullës së re 26.11, “nëse pyetja nuk ka marrë përgjigje brenda dy seancave ajo publikohet në Buletin e Kuvendit.” Buletini i Kuvendit nuk përmban pyetjet që i janë parashtruar Qeverisë, prandaj asnjëra nga pyetjet që nuk ka marrë përgjigje nuk është publikuar ndonjëherë.<sup>11</sup> Në sistemet parlamentare, pyetjet për ministrat paraqesin një mekanizëm të rëndësishëm për mbikëqyrjen e aktiviteteve të ekzekutivit, andaj është e domosdoshme që Kuvendi t’i publikojë në buletin e tij pyetjet e deputetëve që nuk kanë marrë përgjigje brenda afatit të paraparë në rregullën 26.11, gjë që do të mund të kontribuonte në rritjen e përgjegjësisë së Qeverisë ndaj Kuvendit. Në anën tjetër, është poashtu e rekomandueshme që deputetët të jenë të pranishëm në seancat plenare në mënyrë që të marrin përgjigje me kohë në pyetjet e tyre.*

## **4. Qasja dhe pjesëmarrja e barabartë e komuniteteve**

- Kryesia, në takimin e saj më 15 maj, e ka diskutuar letrën e dërguar nga sekretari i përhershëm i Zyrës së Kryeministrit si përgjigje në propozimin e bërë nga Komisioni për të drejtat dhe interesat e komuniteteve.<sup>12</sup> Në letër, sekretari i përhershëm e ka informuar Kryesinë se Qeveria pajtohet me propozimin e Komisionit për të drejtat dhe interesat e komuniteteve dhe ka kërkuar nga Kuvendi që të përgatisë listën me ekspertët ligjorë të cilët u përkasin komuniteteve jo-shqiptare dhe jo-serbe, që do të ftoheshin nga Qeveria për të marrë pjesë në grupet punuese për hartimin e projektligjeve në fushat e ekspertizës së tyre përkatëse. Më 28 maj, pas marrjes së përgjigjes nga Zyra e Kryeministrit, Komisioni për të drejtat dhe interesat e komuniteteve i ka parashtruar një kërkesë Kryesisë ku ka sugjeruar që Zyra Ligjore e Qeverisë ta kontaktojë komisionin para se të fillojë hartimin e secilit ligj, në mënyrë që komisioni t’i rekomandojë ekspertët e tij. Kryesia, në mbledhjen e saj të mbajtur më 14 qershor, e ka miratuar kërkesën e komisionit dhe ka vendosur t’ia përcjellë Zyrës së Kryeministrit. Zyra e Kryeministrit nuk është përgjigjur ende në këtë kërkesë.

## **5. Qasja**

- Gjatë periudhës raportuese, Shtylla e III-të (OSBE) ka pasur qasje në seancat plenare dhe në mbledhjet e komisioneve. Monitoruesi i Kuvendit i Shtyllës së III-të (OSBE) nuk është lejuar të

<sup>11</sup> Shiko raportet 02/2007, 01/2007, 07/2006, 06/2006 dhe 05/2006 të shtyllës III (OSBE) mbi monitorimin e Kuvendit të Kosovës, pjesën e titulluar “Pyetjet për Qeverinë”.

<sup>12</sup> Më 26 mars, Komisioni për të drejtat dhe interesat e komuniteteve i ka dorëzuar Kryesisë propozimin ku ka kërkuar nga Qeveria t’i përfshijë përfaqësuesit e komuniteteve jo-shqiptare dhe jo-serbe në grupet punuese për hartimin e projektligjeve. Në mbledhjen e mbajtur më 10 prill, Kryesia e ka miratuar propozimin e Komisionit dhe ia ka përcjellur atë Zyrës së Kryeministrit. Shiko raportin 02/2007 të Shtyllës III (OSBE) mbi monitorimin e Kuvendit, pjesa e titulluar “Qasja dhe pjesëmarrja e barabartë e komuniteteve”.

marrë pjesë në pjesën e dytë të mbledhjes së Kryesisë më 14 qershor dhe 5 korrik. Këto dy raste janë të vetmet ku Monitoruesi i Kuvendit nuk është lejuar të qëndrojë gjatë gjithë mbledhjes së Kryesisë që nga themelimi i mekanizmit për monitorimin e Kuvendit në dhjetor 2002. Monitoruesit të Kuvendit i është lejuar të qëndrojë deri në fund të mbledhjes së Kryesisë të mbajtur më 20 korrik. Shtylla e III-të gjithashtu ka pranuar kopjet e dokumentave të shqyrtuara nga Kuvendi si dhe transkriptin e seancave të kaluara.

## **6. Transparenca**

- Radio Televizioni i Kosovës (RTK) ka siguruar transmetimin e drejtpërdrejtë të seancave plenare në fjalë. Publikut dhe monitoruesve institucional iu është mundësuar hyrja në seancat plenare. Kuvendi ka web-faqen ([www.assembly-kosova.org](http://www.assembly-kosova.org)) që përmban detaje biografike të deputetëve të Kuvendit, informacione për strukturën dhe funksionimin e Kuvendit, kopje të ligjeve dhe rezolutave të miratuara nga Kuvendi, si dhe informacione të tjera në gjuhën shqipe, serbe dhe angleze.

## **7. Rekomandimet kryesore**

- I rekomandohet komisioneve të Kuvendit t'i shqyrtojnë projektligjet brenda kohës së paraparë në rregullën 35.6 dhe gjithashtu ta shfrytëzojnë rregullën 35.7, e cila u lejon komisioneve t'i shqyrtojnë projektligjet para leximit të tyre të parë, në mënyrë që procesi legjislativ të bëhet më efektshëm.
- Është e këshillueshme që Kuvendi aktual ta qartësojë procedurën për shqyrtimin dhe miratimin e amendamenteve në Rregulloren e Punës, gjë që mund të jetë shumë e dobishme për Kuvendin e ardhshëm.
- I rekomandohet Kuvendit që së shpejti të vendosë se si t'i procedojë gjatë pjesës së mbetur të mandatit projektligjet e mbetura në procedurë. Nëse Kuvendi dëshiron ta shpejtojë shqyrtimin dhe miratimin e projektligjeve që janë ende në procedurë, atëherë mund t'i kthehet sistemit të mbajtjes së seancave plenare çdo javë.
- Është e domosdoshme që Kuvendi t'i publikojë në buletin e tij pyetjet e deputetëve që nuk kanë marrë përgjigje brenda afatit të paraparë në rregullën 26.11, gjë që do të mund të kontribuonte në rritjen e përgjegjësisë së Qeverisë ndaj Kuvendit.

FUND.